

VENDIM
Nr.393, datë 30.11.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “TV EGNATIA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.011/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Egnatia Televizion” sh.a. për televizionin “TV Egnatia”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj